V E N D I M
Nr.426, datë 9.7.1998

PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË QË VDESIN BRENDA DHE JASHTË SHTETIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 788, datë 26.11.2003)

(I përditësuar)

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për çdo rast fatkeqësie (vdekje), Buxheti i Shtetit jep një ndihmë për shtetasit, sipas vendbanimeve dhe grupmoshave, në masën e përcaktuar në bazë rrethesh, të grupuara në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. *Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit* përballon ndihmën në rast fatkeqësie, sipas pikës 1, vetëm për shtetasit, vendbanimet e të cilëve janë në zona urbane.

Për shtetasit, vendbanimet e të cilëve janë në zona rurale, *Qarqet* dhe komunat, brenda fondeve të tyre, të japin në rast fatkeqësie (vdekje) një ndihmë sipas pikës 1, e cila përballohet nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet *Qarqeve* dhe komunave përkatëse.

3. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, me fonde të Buxhetit të Shtetit, organizon shërbimin e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimburson një pjesë të këtyre shpenzimeve.

Rastet e veçanta dhe masa e kontributit të shtetit në përballimin e shpenzimeve të varrimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Financave.

4. *Qarqet* organizojnë heqjen, transportimin dhe rivarrimin e eshtrave të të ekzekutuarve, me ose pa vendim gjyqi, të të burgosurve politikë, që kanë vdekur në burg ose në vendet e dënimit, pa u dënuar, si dhe të të vrarëve në kufi, në orvajtje për t'u arratisur.

Shpenzimet përballohen nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet buxhetit të *Qarqeve* përkatëse.

5. *Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit*, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ngarkohet të nxjerrë udhëzimin përkatës për mënyrën e organizimit të këtij shërbimi dhe të financimit e të likuidimit të tij.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.372, datë 28.8.1992, nr.484, datë 10.11.1992, nr.189, datë 16.4.1993 dhe nr.8, datë 17.11.1994, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lista e rretheve të grupuara sipas masës së ndihmës në rast fatkeqësie:

Nr.	Rrethi	Zonat urbane		i Zonat Rurale	
		0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç	0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç
I	Tiranë	5800	9600	2200	3600
II	Shkodër	5000	8400	2200	3600
	Durrës	5000	8400	2200	3600
	Elbasan	5000	8400	2200	3600
	Vlorë	5000	8400	2200	3600
	Korçë	5000	8400	2200	3600
	Fier	5000	8400	2200	3600
	Berat	5000	8400	2200	3600
	Gjirokastër	5000	8400	2200	3600
	Kavajë	5000	8400	2200	3600
	Krujë	5000	8400	2200	3600
	Lezhë	5000	8400	2200	3600
	Lushnjë	5000	8400	2200	3600
	Pogradec	5000	8400	2200	3600
	Sarandë	5000	8400	2200	3600
	Dibër	4300	7200	2200	3600
	Gramsh	4300	7200	2200	3600
	Kolonjë	4300	7200	2200	3600
	Kukës	4300	7200	2200	3600
	Kurbin	4300	7200	2200	3600
	Librazhd	4300	7200	2200	3600
	Mirditë	4300	7200	2200	3600
	Mat	4300	7200	2200	3600
	Përmet	4300	7200	2200	3600
	Pukë	4300	7200	2200	3600
	Skrapar	4300	7200	2200	3600
	Tepelenë	4300	7200	2200	3600
	Tropojë	4300	7200	2200	3600
	Bulqizë	4300	7200	2200	3600
	Delvinë	4300	7200	2200	3600
	Devoll	4300	7200	2200	3600
	Has	4300	7200	2200	3600
	Kuçovë	4300	7200	2200	3600
	Mallakastër	4300	7200	2200	3600
	Peqin	4300	7200	2200	3600
	Malësi e Madhe	4300	7200	2200	3600